

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shqipe Qerimi kryetare e kolegjit, Ferit Osmani dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.A., nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale Vjedhje pylli, nga neni 285 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK)-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit K.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, P.nr.40/2013, datë 05.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 18.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së të akuzuarit K.A., detyrimisht, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, P.nr.40/2013, datë 05.02.2018, përkitazi me cilësimin juridik të verës penale dhe vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, veprimet e të akuzuarit i cilson në vepër penale Vjedhje pylli, nga neni 358 par.2 të KPRK-ës dhe për këtë vepër penale ndaj të akuzuarit K.A. e refuzon akuzën në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 91 par. 6 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Ankesa e të akuzuarit K.A. është jo lëndore.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, me aktgjykimin P.nr.40/2013, datë 05.02.2018, të akuzuarin, K.A., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje pylli, nga neni 285 par.2 të KPK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale. Është obliguar i akuzuari që të dëmtuarës Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari zyra në Lipjan t'ia kompensoj shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 1,678.00 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit. Është obliguar i akuzuari që kësaj gjykate në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur :

I akuzuari dhe atë vetë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi kërkesën

pasurore-juridike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish në tërësi dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr. 879/2018, datë 17.09.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën konform dispozitës së nenit 390 të KPRK-ës, ku i njoftoi të gjitha palët. Në seancë prezantuan përfaqësuesja e palës së dëmtuar APK-F.M. e cila ndaj të akuzuarit i bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtrroi kërkes pasuroro juridike. Palët tjera edhe pse të njoftuar në kohë dhe mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

-Me rastin e ankesës së të akuzuarit K.A., aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Mirëpo, meqë se para se kjo çështje të merr formën e prerë është ndryshuar ligji penal është nxjerr Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) i cili ka hyrë në fuqi me 01. Janar të vitit 2013, në pajtim me dispozitën e nenit 3 par. 2 të këtij Kodi, obligim i gjykatës që ndaj kryerësit të zbatohet ligji i cili është më i favorshëm, kështu krahasuar me dispozitën e nenit 285 par.2 të KPK-ës të Kodit të mëparshëm, sipas të cilës dispozitë për këtë veprë penale ka qenë i paraparë dënimi me gjobë ose burgim prej 6 muajve deri në 5 (pesë) vite, dispozita e nenit 358 par. 2 të KPRK parashih dënim me gjobë dhe burgim prej 3 (tre) muajve deri në 3 (tri) vite, e cila dispozitë është më e favorshme për kryerësin e veprës , andaj, Gjykata ka bërë ri cilësimin e kësaj veprë penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari K.A. është shpallë fajtor për veprën penale Vjedhje pylli, nga neni 285 par.2 të KPK-së, e të cilën veprë penale tani kolegji penal i kësaj gjykate e cilësoji në veprë penale Vjedhje pylli, nga neni 358 par.2 të KPRK-ës për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe burgim prej 3(tre) muajsh deri në 3 (tri) vite. Sipas dispozitës së nenit 106 par.1 pika 1. 5 të KPRK-së, për veprë penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tri) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kjo veprë penale është kryer datë 29.02.2012, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale me datë 29.02.2012 e deri në arritjen e lëndës me ankesë në Gjykatën e Apelit me datën 16.08.2018, gjyqtarit të çështjes i është dorëzuar me 19.09.2018, kurse deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj gjykate më 14.06.2018 kanë kaluar me shumë se 6 (gjashtë) vite, gjegjësisht nga koha e kryerjes së veprës penale me datë 29.02.2012 e deri në kohën e ngarkimit të lëndës te gjyqtari i çështjes me datë 19.09.2018, kanë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite, nga këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për ç'arsye ankesa e akuzuarit është jo lëndore. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par. 1 të KPP-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.873/18, datë 18.10.2018

Bashkë. profesionale
Leonita Lajqi

Kryetari i kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Gani Zabeli